



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:194227
Datë: 02.04.2025
Numri i dokumentit: 07080184

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.57/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës në Mitrovicë-Veri), kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues Xhemajl Jusufi dhe Izet Gërguri, procesmbajtësja Edita Kelmendi, në çështjen penale kundër të pandehurës Zlata Bojoviq, për shkak të veprës penale: Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga nenin 278 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.105/2016 dt.28.02.2022. Në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimi gjyqësor që ka qenë e hapur për publikun, dhe është mbajtur në prezencën e palëve; Prokurores së Shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurës Zlata Bojoviq, mbrojtësit të saj, av.Srgjan Mitrovic. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 01.04.2025 të njëjtën ditë është shpall publikisht aktgjykimi, ndërsa më 02.04.2025 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

E pandehura;

- ZLATA BOJOVIQ nga i ati , e ëma e gjinisë , (data e lindjes) në fsh.....-Komuna L....., tani më vendbanim në fsh.....-L....., serbe, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal të ID;....., ka të kryer shkollën e mesme, e ve, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, më parë e pa gjykuar, ndaj saj nuk zhvillohet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale, e njëjta;

Në mbështetje të nenit 362 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

REFUZOHET AKUZA

- Sepse:

Deri më 22 Gusht 2015, në L....., në vendin J....., pa autorizim ka kultivuar bimë të kanabisit me qëllim të prodhimit të drogës ose substancës psikotrope, në atë mënyrë në një livadh në të cilën është pronare, e pandehura ka kultivuar tri (3) bimë narkotike të cilat janë zbuluar nga

policia dhe më pas janë sekuestruar dhe pas ekzaminimit të tyre ka treguar se përbëjnë bimë narkotike të llojit kanabis (THC).

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga nenin 278 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- E pandehura lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e procedurës mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- Në mbështetje të nenit 276 par.1 e 2 të KPRK-së, si dhe nenit 278 par.2 KPRK-së, Gjykata URDHËRON konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim; Tri (3) bimëve narkotike të llojit kanabis THC, të cilat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.
- Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr.105/2016 dt.28.02.2022, kundër të pandehurës Zlata Bojoviq, për veprën penale, Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga nenin 278 par.1 të KPRK-së.

- Kompetenca;

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale dyshohet se ka ndodhur në L..... dhe rrjedhimisht, bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPP-së. Sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo natyrë e veprave penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas nenit 22 par.1, nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2 pika 1.2.66 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) hynë në kompetencë të Departamentit për krime të rënda.

- Rrjedha e procedurës:

Më datën 14.07.2022 Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve, Prokurores së shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Natasha Radoviq, të pandehurës Zlata Bojoviq si dhe mbrojtësit të tij, av.Srgjan Mitroviq. E pandehura Zlata Bojoviq në seancën e shqyrtimit fillestar nuk e ka pranuar në fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, sipas akuzës së prokurorisë.

Gjykata iu ka dhënë mundësi palëve që brenda afatit prej 30 ditësh t'i paraqesin kundërshtimet e tyre. Brenda afati ligjor mbrojtësi i të pandehurës av.Srgjan Mitroviq ka parashtruar kundërshtimet e tij.

Më datë 04.09.2022 Gjykata Themelore në Mitrovicë, ka nxjerr aktvendimin me të cilin ka refuzuar kundërshtimin e mbrojtësit av.Srgjan Mitrovicë. Mbrojtësi më dt.09.09.2022 ka parashtruar ankesën kundër aktvendimi të Gjykatës Themelore në Mitrovicë,

Gjykata e Apelit sipas vendimit PN.mr.1003/2022 dt.21.10.2022 ka refuzuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit av.Srgjan Mitroviq dhe ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë si i tillë vendimi është bërë i plotfuqishëm.

Më datën 01.04.2025 është mbajtur shqyrtimi gjyqësor në prezencën palëve. Gjatë seancës gjyqësore, prokurorja e çështjes është tërhequr nga akuza dhe ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurës Zlata Bojoviq, me arsyetimin se nuk është arritur që të dëshmohet fajësia e të pandehurës për veprën penale për të cilën ka qenë e akuzuar.

- Gjetjet e gjykatës:

Pasi që prokurori e shtetit në PTH- Mitrovicë, është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurës Zlata Bojoviq, për veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga nenin 278 par.1 të KPRK-së, kjo gjykatë vlerëson se sipas nenit 51 të KPP-së, prokurori ka të drejtë ligjore që deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të tërhiqet nga ndjekja penale. Bazuar në këto arsye, kjo Gjykatë konstaton se në mungesë të aktakuzës nuk mund të vazhdohet shqyrtimi i mëtejme i kësaj çështjeje penale. Mbi këto arsye, gjykata gjen se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore që të refuzohet akuza e prokurorisë në përputhje me nenin 362 par.1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Lidhur me lirimin e të pandehurës nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPP-së.

- Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.57/2022 datë 02.04.2025

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pas pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.